



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 9759 prot.

Roskovec, më 01.11.2022

VENDIM

Nr. 82, datë 31.10.2022

PËR

MIRATIMIN NË PARIM PËR VËNIEN NË PËRDORIM TË TOKËS NË PRONËSI TË
BASHKISË ROSKOVEC PËR PROJEKTET NË FUSHËN E BUJQËSISË

Në mbështetje të nenit 9 pika 1 paragrafi 1.2 shkronja (a) dhe nenit 54 shkronja “e/1” të Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Miratimin në parim për vënien në përdorim të pasurisë Nr. 406/1-F Zona Kadastrale 3196 me sipërfaqe 2 ha në pronësi të bashkisë Roskovec për projektet në fushën e bujqësisë dhe konkretisht për projekt-propozimin: “Linjë përpunimi të perimeve të fushës, përdorimi energjisë solare”.
2. Vënia në përdorim e pasurisë do të realizohet pas miratimit të projekt-propozimit nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Bashkia Roskovec.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

